



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 41/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, z. Petrit Reçica, dhe përmbaruesit privat z. _____, dhe pas seancës këshillimore, me datën 17.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-41/2021, datë 05.10.2021, Raporti i Divizionit për mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së punës për profesionet e lira dt 04.10.2021, si dhe Ankesa nga pala ankuese z. _____, dt 29.06.2021, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 29.06.2021, pala ankuese z. _____ ka paraqitur ankesë në Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira ndaj përmbaruesit privat z. _____, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në _____. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat në mënyrë të kundërligjshme ka shtyrë prindin e tij - babain e tij, z. _____, si palë debitore të bëjë marrëveshje për ta paguar borxhin me këste, me ç'rast prindi i tij z. _____ pa vetëdije, ka nënshkruar marrëveshjen mbi bazën e së cilës borxhi do të paguhej me pensionin e tij.

Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira ka zbatuar inspektimin dhe me dt 04.10.2021 ka përgatitur Raportin për kryerjen e inspektimit të veçantë lidhur me lëndën në fjalë të identifikueshme me nr P. nr 19/2018. Sipas raportit, përmbartuesi privat z.

ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore. Raporti thekson që procesverbalet e marrëveshjes për pagesë me këste të detyrimit dt 25.01.2019 dhe dt 08.01.2020, janë të nënshkruara nga vet pala debitore dhe se nuk ka asnjë shkresë që konstaton që pala debitore kishte refuzuar apo kishte shprehur mungesë të vullnetit për të lidhur marrëveshjen e theksuar. Derisa procesverbali i marrëveshjes së dt 25.01.2019 është nënshkruar nga pala debitore dhe përmbartuesi privat, procesverbali i marrëveshjes së dt 08.01.2020 është nënshkruar nga pala debitore, ndërsa në vend të nënshkrimit të përmbartuesit privat është nënshkruar nga dikush tjetër në emër të përmbartuesit privat, siç edhe konstatohet në procesverbal "për" përmbartuesin privat z.

Po ashtu, raporti në fjalë thekson që edhe urdhri për bllokimin e llogarive bankare dt 22.06.2021 nuk është nënshkruar fare nga përmbartuesi privat por vetëm ka vulën dhe emrin dhe mbiemrin në formë vule (faksimili), ndërsa urdhri i dt 29.06.2021 për transferimin e mjeteve është nënshkruar por nënshkrimi i përmbartuesit privat nuk ka ngjashmëri me nënshkrimin paraprak.

Me datën 05.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit private z. , si organ përmbartues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbartimore në lëndën përmbartimore P. nr 19/2018.

Përmbartuesi privat z. ka dhënë përgjigjen e tij me shkrim me 06.10.202, e cila, në thelb, nuk lidhet me pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore ndaj tij. Përmes një gjuhe ofensive e cila në përmbajtje nuk ka të bëjë me një sjellje profesionale që kërkohet, përmbartuesi privat z. më tepër shpreh kritika ndaj zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë - Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesionet e Lira për raportin e tyre lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë.

Me datën 17.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, përfaqësuesi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, z. Petrit Reçica dhe përmbartuesit privat, z. SHKRESETI PËR

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e Raportit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Përfaqësuesi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, z. Petrit Reçica gjithashtu ka bërë elaborimin e raportit të inspektimit duke theksuar se mbetet pranë të njëjtit. Përmbartuesi privat z. po ashtu kanë paraqitur qëndrimin e tij dhe ka kërkuar refuzimin e raportit.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit,

vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. Krasniqi nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson që Raporti i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, në thelb, konsiston në pretendimin se procesverbali i marrëveshjes së dt 25.01.2019 është nënshkruar nga pala debitore dhe përmbaruesi privat z. , ndërsa procesverbali i marrëveshjes së dt 08.01.2020 është nënshkruar nga pala debitore, kurse në vend të nënshkrimit të përmbaruesit privat, është nënshkruar nga dikush tjetër në emër të përmbaruesit privat, siç edhe konstatohet në procesverbal “për” përmbaruesin privat z.

Po ashtu, Raporti në fjalë thekson që edhe urdhri për bllokimin e llogarive bankare dt 22.06.2021 nuk është nënshkruar fare nga përmbaruesi privat por vetëm ka vulën dhe emrin dhe mbiemrin në formë vule (faksimili), ndërsa urdhri i dt 29.06.2021 për transferimin e mjeteve është nënshkruar por nënshkrimi i përmbaruesit privat nuk ka ngjashmëri me nënshkrimin paraprak. Rrjedhimisht, çështja që shtrohet para Komisionit Disiplinor është nëse dikush tjetër mund të nënshkruaj në vend të përmbaruesit privat për aq kohë sa nuk është emëruar zëvendësuesi i përmbaruesit privat.

Sipas nenit 339 par 1 të LPP, përmbaruesi privat është përgjegjës për kryerjen e veprimeve përmbarimore në pajtim me dispozitat e ligjit. Përmbaruesi privat sipas par 2 të nenit të njëjtë, kryen veprimet përmbarimore dhe në bazë të autorizimeve të tij edhe “zëvendësi i përmbaruesit privat apo i punësuarit i tij.” Personat e autorizuar nga përmbaruesi privat veprojnë në emër dhe për llogari të përmbaruesit privat. Rrjedhimisht, është e qartë se neni 339 bën dallimin mes, në njërin anë, të zëvendësuesit të përmbaruesit privat, e i cili duhet të emërohet nga ana e Ministrit të Drejtësisë dhe të autorizuarit, përkatësisht, të punësuarit të përmbaruesit privat, në anën tjetër. Zëvendësuesi i përmbaruesit privat e zëvendëson përmbaruesin privat të caktuar kur ai përmbaruesi privat pengohet në kryerjen e veprimeve përmbarimore në ndonjë mënyrë: për shkak të sëmundjes, mungesës apo revokimit të përkohshëm të drejtës për ushtrimin e profesionit. Emërimi i zëvendësuesit të përmbaruesit privat, siç u tha, bëhet nga Ministri i Drejtësisë kur plotësohen kushtet ligjore dhe në pajtim me dispozitat e nenit 354 të LPP-së. Ndryshe nga Zëvendësuesi i përmbaruesit privat, i punësuarit tek përmbaruesi privat vepron në emër dhe për llogari të përmbaruesit privat dhe i njëjti autorizohet nga ana e përmbaruesit privat që të ndërmarr veprime përmbarimore.

Në rastin në fjalë, procesverbali i marrëveshjes së dt 25.01.2019 është nënshkruar nga pala debitore dhe përmbaruesi privat. Ndërsa procesverbali i marrëveshjes së dt 08.01.2020 është nënshkruar nga pala debitore, ndërsa në vend të nënshkrimit të përmbaruesit privat është nënshkruar nga i punësuarit i përmbaruesit privat, përkatësisht, nga z. në emër të përmbaruesit privat, z. , siç edhe konstatohet në procesverbal “për” përmbaruesin privat z.

Gjithashtu edhe urdhri i dt 29.06.2021 për transferimin e mjeteve është nënshkruar nga i autorizuarit i përmbaruesit privat z. . Autorizimet e të punësuarit z. që të nënshkruaj në emër të përmbaruesit privat z. dalin nga autorizimi për kryerjen e veprimeve përmbarimore A. nr 02/2019, dt 01.01.2019, e cila konform nenit 339 par 2 dhe 3 të LPP-së, është nënshkruar mes përmbaruesit privat z. dhe personave- stafit të punës, të cilët përmbaruesi privat i autorizon se “mund dhe duhet të kryejnë veprime përmbarimore në të gjitha lëndët që janë në procedurë në zyre të përmbaruesit privat.” Rrjedhimisht, nënshkrimet në procesverbalin e marrëveshjes dhe urdhrin për transfere të cekura më lartë, janë bërë nga personat e autorizuar. Autorizimi për të punësuarin z. , që të ndërmarr veprime përmbarimore

në lëndët e përmbauesit privat, ishte bërë në vitin 2019, ndërsa marrëveshja në fjalë në vitin 2020. Kjo do të thotë se përmbauesi privat z. _____ kishte autorizuar të punësuarin e tij të ndërmarr veprime përmbaimore. Z. _____ kishte autorizimet nga përmbauesi privat për të ndërmarr veprimet përmbaimore.

Për sa i përket gjuhës së përdorur nga përmbauesi privat në përgjigjen e tij, meqenëse nuk është ngritur pretendim për sjellje disiplinore dhe çështja është adresuar në Komisionin e Etikës pranë Odës së Përmbauesve Privat, Komisioni Disiplinor mjaftohet në konstatimin që nga përmbauesit privat kërkohet të tregojnë sjellje sipas standardeve të sjelljes etike dhe profesionale që dalin nga pozita e tyre juridike.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 41/2021, datë 17.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.